



Çfarë kuptojmë nga njohja që Jezusi shfaqte në çështjet e jetës së përditshme

Description

Atë Raymond Brown

Fragment i shkëputur nga libri i Atë Raymon Brown me titull: “An Introduction to New Testament Christology”, Paulist Pres, New York 1994

Gjenden tekste të ndryshme tek ungjijtë që duket se tregojnë se Jezusi ka zotëruar në njohje të thjeshtë e të kufizuar njerëzore në çështjet e jetës së përditshme, ekzistojnë edhe tekste të cilat i veshin atij njohuri mbinjerëzore në lidhje me këto çështje.

Tekste që tregojnë njohje të kufizuar

(1) *Gjatë jetës ministore të tij.* Shembulli më i mirë për të dëshmuar një gjë të tillë gjendet tek Marku 5:30-33. Jezusi ishte duke ecur në mes të një turme: një grua i preku rrobat e tij dhe u shërua menjëherë falë fuqisë çudibërëse të tij. Duke ndjerë se një energji kishte dalë prej tij, Jezusi pyeti se kush e kishte prekur. Dishepujt menduan se kjo ishte një pyetje qesharake duke pasur parasysh se turma po shtyhej nga të gjitha anët, por gruaja bëri përpara dhe rrëfeu. Ky rrëfim nënkupton paditurinë e Jezusit për këtë çështje, ndonëse ajo nuk është qendrore për rrëfimin. Ngjarja është e njëjtë ndonëse me tone më të ulëta edhe tek Luka 8:45-47, por Mateu 9:22 e lë jashtë përshkrimin e pyetjes së Jezusit dhe kërkimin e tij për gruan.¹ Tek Mateu Jezusi u kthye, e pa gruan dhe njohu menjëherë se çfarë kishte ndodhur. Me shumë mundësi rrëfimi tek Marku ka më shumë gjasa të jetë i vërteti, ndërsa Mateu duket se reflekton një siklet për paditurinë që Marku i vesh Jezusit.²

(2) *Gjatë djalërisë.* Gjenden dy tekste tek ungjilli i Lukës që meritojnë vëmendje. Tek Luka 2:46 paraqitet Jezusi, në moshën dymbëdhjetë vjeçare, duke i bërë pyetje dijetarëve të ligjit. Verseti pasardhës rrëfen sesi dijetarët habiteshin me zgjuarsinë e tij dhe nga përgjigjet që jepte. Jezusi paraqitet këtu si një fëmijë me zhvillim të parakohshëm, i etur për dituri. Tek Luka 2:52 menjëherë pas kësaj skene, tregohet se Jezusi po rritej në dituri, në shtat dhe në hir përpara Perëndisë. Kjo është një formulë e stereotipizuar, një pohim i ngjashëm është bërë edhe për Samuelin tek 1 Samuel 2:26 dhe për Gjon Pagëzorin tek Luka 1:80. Nga një këndvështrim kritik këto tekste vështirë se mund të

përdoren për të rindërtuar jetën e Jezusit, për arsye se nuk ka asnjë mënyrë shkencore për të vërtetuar materialin që gjendet tek rrëfimi i Lukës (ekziston edhe një tjetër ungjill kanonik që flet për fëmijërinë e Jezusit; ne nuk dimë asgjë për burimet e Lukës). Sidoqoftë, është e qartë se ungjillori nuk sheh asnjë vështirësi dhe asgjë të çuditshme në paraqitjen e Jezusit si një djalë që bën pyetje apo rritet në dije (normale njerëzore). Ky është një gjykim i rëndësishëm pikërisht për faktin se sipas Lukës, Jezusi është paraqitur si Biri i Perëndisë që në çastet e para të konceptimit të tij.

Tekste që tregojnë një dituri të veçantë mbinjerëzore

3. *Mohimi i kufizimeve.* Ekziston një prirje tek ungjijtë e vonshëm për të shtypur çdo sugjerim se Jezusi kishte nevojë të merrte dije njerëzore. Ne e kemi parë tashmë rastin e Mateut tek shembulli i parë, por kjo është e vërtetë veçanërisht për Gjonin. Nëse tek Gjoni 6:5 Jezusi e pyet Filipin se ku do ta blinin bukën për të ushqyer turmën, në shtesën shpjeguese të versetit pasardhës insistohet se Jezusi ishte thjesht duke vënë në provë Filipin, sepse Jezusi e dinte shumë mirë se ç'do të bënte, në mënyrë implicite nënkuptohet se ai e dinte që në turmë ishte një djalosh që kishte një kanistër me pesë bukë elbi dhe dy peshq (6:9). Ndonëse Jezusi kishte zgjedhur disa dishepuj me cilësi të varfra, gjithsesi ai ishte e dinte që nga fillimi se kush ishin ata që nuk besonin (Gjoni 6:64). Veçanërisht, ai e dinte se Judai Iskarioti do ta tradhtonte atë (6:71; 13:11). E gjithë kjo është pjesë e dëshirës së Gjonit për të mos paraqitur asnjë element të dobësisë njerëzore apo varësisë tek Jezusi³. Në ungjillin e Gjonit 10:18 Jezusi mund të pohojë në lidhje me vdekjen e tij: “*Askush nuk mund të ma heqë jetën, por e lë nga vetja; unë kam pushtet ta lë e pushtet ta marr përsëri...*”. Ndonëse Gjoni këmbëngul se Fjala u bë mish (1:14), E. Käsemann pohon se Jezusi nuk ka pësuar një kenosis, d.m.th. një zbrazje të vetes për të zbritur në gradën më të ulët (siç pohohet tek 2 Filipjanëve 6-8). Në Jezusin e mishëruar madhështia e Birit të Perëndisë në mënyrë të vazhdueshme shfaqet për këdo që ka sy për të parë.³

4. *Aftësia për të lexuar mendjet.* Të gjithë ungjijtë i veshin Jezusit aftësinë për të njohur mendimet e njerëzve edhe nëse ato nuk e kishin shprehur asnjëherë (Marku 2: 6-8 dhe paralelet; Marku 9:33-35 me Lukën 9:46-47; Gjoni 2:24-25; 16:19 dhe 30). Një aftësi e tillë nuk është e pazakontë në ngjarjet që rrëfohen për figura të shquara religjioze, kjo e bën të detyrueshme pyetjen nëse kjo dhunti, nëse është historikisht e vërtetë, paraqet një mendjemprehtësi të natyrës njerëzore apo një dituri mbinatyrore. Sigurisht tek Gjoni, e ndoshta edhe tek ungjijtë e tjerë, ungjillori hamendëson opsionin e dytë.

5. *Njohja në largësi.* Të gjithë ungjijtë rrëfejnë për ngjarje ku Jezusi tregohet se zotëron njohuri, përtej aftësive njerëzore, të ngjarjeve që po ndodhnin diku tjetër.

(a) Tek Gjoni 1:48-49 Jezusi kuptoi (kishte parë) se çfarë po bënte Nataneli nën pemën e fikut, kjo e habiti Natanelin.

(b) Tek Marku 11: 2 dhe paralele, rrëfëhet se kur Jezusi po përgatitej për të hyrë në Jeruzalem ai i udhëzoi dishepujt e tij për të shkuar në fshatin fqinj, në hyrje të tij ato do të gjenin një mëz të lidhur që nuk i kishte hipur askush më parë⁵. Kjo histori nuk gjendet tek Gjoni, tek i cili rrëfimi i hyrjes në Jeruzalem të Jezusit gjendet në një formë më primitive se ajo e ungjijve Sinoptik. Tek Gjoni 12:14 është vetë Jezusi që e gjen kafshën.

(c) Tek Marku 14:13-14 dhe tek Luka 22:10-11 kur po bëheshin përgatitjet për Pashkë Jezusi dërgoi dy prej dishepujve të tij me këtë udhëzim: “*Shkoni në qytet dhe atje do të takoni një njeri, që bart një kanë plot me ujë; ndiqeni atë. Dhe atje ku ai do të hyjë, i thoni të zotit të shtëpisë: “Mësuesi pyet: Ku është dhoma ku mund të ha Pashkën me dishepujt e mi?”*

“. Duhet të vërejmë se në rrëfimin tek Mateu 26:18 nuk gjejmë gjurmë të kësaj njohje të fshehtë të asaj që do të ndodhë. Jezusi i Mateut thjesht i ka udhëzuar dishepujt e tij që të shkojnë tek shtëpia e dikujt e të përgatisin pashkën.

(d) Tek Mateu 17: 24-27 trajtohet çështja nëse Jezusi ka paguar taksën e caktuar, e nëse dishepujt e tij duhet ta bënin këtë apo jo. Jezusi i thotë Pjetrit të shkojë në liqenin e Galilesë dhe peshkun e parë që ai do të kapte do të kishte monedhën në gojën e tij. Kjo do të mjaftonte për të paguar taksën si për vete ashtu edhe për dishepujt e tij. Në rrëfim nuk tregohet nëse Pjetri veproi në këtë mënyrë apo jo dhe nëse e gjeti apo jo monedhën, por gjithsesi kjo nënkuptohet nga rrëfimi. Kjo histori gjendet vetëm tek Mateu, me shumë mundësi prejardhjen e ka nga tradita e veçantë Petrine që është ruajtur tek Mateu (14:28-33; 16: 16b-19). Qëllimi kryesor i episodit është didaktik (problemi i pagimit të taksës nga të krishterët, shoqërimi i Pjetrit me Jezusin)⁶; njohja e Jezusit se monedha do të gjendej në gojën e peshkut (ndoshta simbolizon se Perëndia do ti pajiste të krishterët me mjetet e duhura për të kryer obligimet e tyre ndaj shtetit, si në këtë rast) është rastësore. Pavarësisht nga qëllimi didaktik, ky është një nga ato pak mrekulli të Jezusit që shfaq ngjashmëri me një veprim magjik, e denjë për heronjtë çudibërës të përrallave helene. Shumë teologë e konsiderojnë këtë episod një përrallë popullore, si në rrëfimin e lindjes ashtu edhe në pasionin e Jezusit, Mateu shfaq një damar të huazimit të materialit dramatik popullor në të cilin rrëfohen ngjarje të mrekullueshme (një yll që tregon lindjen e Mbretit të Judenjve; tërmeti në vdekjen e Jezusit dhe në ringjallje, shenjtorët që ngrihen nga varret dhe shfaqen nëpër qytet).

Gjatë shqyrtimit të këtyre episodeve ne përballemi me disa vështirësi. Ndodhia (a) dhe (b) nuk verifikohen nga asnjë burim tjetër, ndërsa (d) është skajshmërisht e vështirë. Në ndodhitë (b) dhe (c) ekziston edhe një tjetër version në të cilin këto cilësi të jashtëzakonshme nuk shfaqen. Pavarësisht nga këto fakte edhe nëse do të na duhej të vendosnim nëse këto ngjarje janë pjesë e traditës së hershme për Jezusin, përsëri duhet të jemi të kujdesshëm për të mos bërë asnjë pohim teologjik që mund t'ia veshë këtë aftësi qenies së tij hyjnore. Dhjata e Re ia ka veshur këto aftësi shumë profetëve, p.sh. Ezekieli që jetonte në Babiloni kishte vizione të ngjarjeve që ndodhnin në Jeruzalem. Dhuntia e një shikimi tej shqisor në distancë nënkuptohet edhe nga historia për Samuelin (1 Samuel 10:1 e më poshtë), kjo ngjarje është shumë e ngjashme me atë të rrëfyer nga Marku 14 që ne e përmendëm nën shembullin (c).

Për ta përmbledhur, siç e kemi parë edhe në fillim të shqyrtimit tonë, në ungjij gjenden tradita të hershme të cilat pranojnë pa vështirësi se Jezusi kishte një njohje të kufizuar njerëzore në lidhje me çështjet e përditshme; me shumë mundësi ndryshimi i këtij fakti nga Mateu dhe Gjoni është një modifikim teologjik sekondar. Nga ana tjetër, me shumë mundësi për aq sa mund ta gjurmojmë traditën, Jezusi paraqitet si një njeri me një dituri dhe perceptim mbinjerëzor në lidhje me ngjarjet përreth. Tek figurat e mëdha profetike dhe religjioze një njohje e tillë e jashtëzakonshme nuk përjashton edhe kufizimet dhe paditurinë në çështjet e tjera, për këtë arsye një kombinim i tyre është i pritshëm edhe për Jezusin.

[*] Atë Raymond Brown është Distinguished Professor Emeritus of Biblical Studies në Union Theological Seminary (N.Y.C.). Ai konsiderohet si një prej figurave qendrore ndërmjet shkollarëve të Dhjatës së Re. Gjatë jetës së tij ka marrë mëse tridhjetë “honorary degrees” nga universitetet katolike dhe protestante nga e gjithë bota, gjithashtu, ai është zgjedhur si (Corresponding) Fellow of the British Academy dhe anëtar i Akademisë Amerikane të arteve dhe shkencave. Autor i mëse tridhjetë e pesë librave në lidhje me Biblën, po ashtu ka qenë i vetmi amerikan që është zgjedhur nga dy papë si

anëtarë i Komisionit biblik papnor.

Përktheu: Rezart Beka

Futnota

[1] Përgjatë gjithë librit unë do të veproj në përputhje me mendimin e pranuar gjerësisht nga shkollarët sipas të cilëve Mateu dhe Luka në mënyrë të pavarur kanë njohur dhe përdorur Markun, pa njohuri të veprave të njeri-tjetrit.

[2] Një zakon i tillë korrigjues ndaj atyre që duken si 'dobësi njerëzore' tek rrëfimi i Markut shfaqen edhe tek Mateu. P.sh. kur Mateu nuk përmend mrekullinë e Jezusit, të përmendur tek Marku 8: 22-26, ku ai u përpoq të shëronte një njeri të verbër, përpjekje kjo që vetëm pjesërisht u tregua e suksesshme si edhe tek zbutja e tonit të ashpër që dishepujt shfaqin ndaj Jezusit tek Marku (krahaso Marku 4:38 me Mateun 8:25).

[3] Gjoni 3:22 raporton se në Jude, Jezusi kishte kryer një mision pagëzimi, një praktikë kjo që mund të tregojë se ai ishte nën ndikimin e Gjon Pagëzorit. Tek 4:2 në mënyrë të kujdesshme ky fakt mohohet, nuk ishte Jezusi që pagëzonte por vetëm dishepujt e tij.

[4] Në apendaksin IV ne do të diskutojmë qëndrimin e Käsemann-it. Gjenden ekzagjerime në të, por duhet pranuar se nëse merret veçantë vetëm portreti i Gjonit për Jezusin ai shfaqet deri diku i një anshëm në favor të hyjnisë së tij. Vetëm duke balancuar Markun me Gjonin kemi mundësinë dhe mbështetjen për ta konsideruar Jezusin njëkohësisht krejtësisht njeri dhe krejtësisht hyjnor.

[5] Tek Mateu 21:2 tregohet për dy kafshë. Mund të argumentohet për këtë shembull si dhe për atë pasardhës se Jezusi paraprakisht kishte rënë dakord me njerëzit e duhur për atë që do të ndodhte, por ungjillorët zor se ka menduar në mënyrë kaq racionale. Ata e kanë parë këtë ngjarje si një dije të jashtëzakonshme të Jezusit.

[6] Për më shumë në lidhje me këtë çështje, shih Peter in the New Testmant, eds. R. E. Brown et al. (New York: Paulist, 1973), 101-5, një libër që zotëron konsensusin si të shkollarëve katolik ashtu edhe të atyre protestantë.

Date Created

14/01/2013

Author

erasmusi